

Tiranë më, 17.03.2023

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**" MEDART CLINIC " SH.P.K**

Sot në date 17.03.2023, duke u bazuar në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë ortakët :

- **Z.Helidon Nina** , i biri i Dhimiër Nina , i datelindjes 26.01.1974 ne Durres , Shqipëri banues ne adresën Rruga Sami Frashëri ,Pallati 34 ,Ap. 10 ,Tiranë , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të, vepruar , mbajtës i letërnjoftimit me numër personal:H40126130K.
- **Z. Roland Hasa** , i biri i Aqif Hasa , i datëlindjes 03.07.1973 ne Bershë , Shqipëri banues në adresën Njësia bashkiake nr. 4 , Rruga Kahreman Ylli , Ndërtesa 32 H.18, Ap.14 ,1005 ,Tiranë , madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i letërnjoftimit me numër personal :H30703121W .

Kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

**Neni 1 – Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është “ **MEDART CLINIC " SH.P.K**

**Neni 2 – Selia**

Selia e shoqërisë është në adresën Tiranë , Rruga Sami Frashëri , Godina nr.32 .

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë 10 vjecare.

#### Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria do të operoj në fushën e shëndetit dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj :

- Klinike mjeksore me të gjitha shërbimet, kontrolle mjekësore, Vizita të ndryshme mjekësore për klientët e saj.
- Klinika do të kryej shërbimin e ekografive dhe konsultes nga mjekët specialistë .
- Shërbime dhe analiza të ndryshme laboratorike .
- Konsulta mjeksore.
- Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë .

#### Neni 5 – Kapitali themeltar

- Kapitali aksioner i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- Kapitali nënshkruhet dhe shlyhet plotësisht nga aksionerët e shoqërisë **Z.Helidon Nina** me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë), përkatësisht 50% (pesëdhjetë përqind) e kapitalit të shoqërisë, dhe **Z. Roland Hasa** me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë), përkatësisht 50% (pesëdhjetë përqind) e kapitalit të shoqërisë.
- Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin e saj deri në kufirin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve .
- Karta e kapitalit të shoqërisë përbëhet nga dy aksione, me vlerë 50 000 (pesë dhjetë mijë).

#### Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - Shitblerjes;
  - Trashëgimisë;
  - Dhurimit;
  - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
2. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së Ortakeve.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

### Neni 7-Organet e shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë

### Neni 8 -Administratorët

Me këtë Akt Themelimi emërohet Administrator i shoqërisë personi si më poshtë:

- **Znj.Klara Mergo** , e bija e Robert dhe Vasilika , e datëlindjes 18.09.1975 ne Durres , Shqipëri, banues Rruga Sami Frashëri ,Pallati 34 ,Ap. 10 Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: H559181340.

### Neni 9 – Legjislacioni

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 10 – Gjuha

Ky akt sipas legjislacionit për institucionin përbëhet nga 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË

MEDART CLINIC " SH.P.K

**Z.Helidon Nina**

Helidon Nina  


**Z. Roland Hasa**

Roland Hasa  
